Udhëzuesi referencë i instaluesit

Kondicionerë sistemi të ndarë



FDXM25F3V1B
FDXM35F3V1B
FDXM50F3V1B
FDXM60F3V1B

FDXM25F3V1B9
FDXM35F3V1B9
FDXM50F3V1B9
FDXM60F3V1B9

Tabela e përmbajtjes

1 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme 2
1.1 Rreth dokumentacionit ... 2
1.1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve ... 2
1.2 Për përdoruesin ... 2
2 Rreth këtij dokumenti 3
2.1 Një vështrim i shpejtë për udhëzuesi referencë të instaluesit ... 3
3 Rreth sistemit 3
3.1 Përbërësit ... 3
3.2 Ndërfaqja e përdoruesit ... 4
4 Para operimit 4
5 Operimi 4
5.1 Gama e operimit ... 4
6 Kursimi i energjisë dhe operimi optimal 5
7 Mirëmbajtja dhe shërbimi 6
7.1 Pamje përgjithshme: Mirëmbajtja dhe shërbimi ... 6
7.2 Pastrimi i tiganit të kullimit ... 6
7.3 Pastrimi i filtrit të ajrit, grilës së thithjes, daljes së ajrit dhe paneleve të jashtëm ... 6
7.3.1 Pastrimi i daljes së ajrit dhe paneleve të jashtme ... 6
7.3.2 Pastrimi i filtrit të ajrit ... 6
7.4 Mirëmbajtja para një periudhe të gjatë ndalese ... 7
7.5 Mirëmbajtja pas një periudhe të gjatë ndalese ... 7
8 Zgjidhja 7
8.1 Simptomat që NUK janë keqfunksionime të sistemit ... 8
8.1.1 Shenja: Sistemi nuk operon ... 8
8.1.2 Shenja: Nga njësia (njësia e brendshme) dalin pikla të bardha ... 8
8.1.3 Shenja: Nga njësia del pluhur ... 8
8.1.4 Shenja: Njësitë mund të lëshojnë aroma ... 8
8.1.5 Simptoma: Operimi ndalon papritur (llamba e operimit ndizet) ... 8
8.1.6 Simptoma: Ventilatori i jashtëm rrotullohet kur kondicioneri nuk është në përdorim ... 8
8.1.7 Simptoma: Operimi i ngrohjes ndalon papritur dhe dëgjohet një zë rrjedhjeje ... 9
9 Hedhja 9
10 Fjalor 9

1 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme

1.1 Rreth dokumentacionit

- Dokumentacioni origjinal është i shkruar në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime.
- Masat paraprake të përshkruara në këtë dokument mbulojnë tema shumë të rëndësishme, ndiqi ato me kujdes.
- Instalimi i sistemit, dhe të gjitha aktivitetet e përshkruara te manuali i përdorimit dhe udhëzuesi referencë i instaluesit DUHET të kryhen nga një instalues i autorizuar.

1.1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve

RREZIK

Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.

RREZIK: RREZIK DJEGIE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.

RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.

ALARM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.

ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM

KUJDES

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.

NJOFTIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.

INFORMACION

Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simboli	Shpjegimi
	Para instalimit, lexoni manualin e instalimit dhe përdorimit, dhe udhëzimet për instalimet elektrike.
	Para kryerjes së detyrave të mirëmbajtjes dhe servisit, lexoni manualin e servisit.
	Për më shumë informacion, shikoni udhëzuesin e instaluesit dhe referencës së përdoruesit.

1.2 Për përdoruesin

- Nëse NUK jeni i sigurt si ta operoni njësinë, kontaktoni instaluesin tuaj.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e lart dhe personat me aftësi të reduktuara fizike, ndijore ose mendore ose me mungesë përvoje dhe njohurie, nëse u janë dhënë mbikëqyrje ose udhëzime lidhur me përdorimin e pajisjes në një mënyrë të sigurt dhe për të kuptuar përfshirjen e rreziqeve. Fëmijët NUK do të luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit NUK do të kryhet nga fëmijë pa mbikëqyrje.

ALARM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

NJOFTIM

- MOS vendos asnjë send apo pajisje mbi njësi.
- MOS u ul, mos u ngjit dhe mos qëndro mbi njësi.

- Njësitë janë të shënuara me këtë simbol:

Kjo do të thotë se produktet elektrike dhe elektronike NUK mund të përzihen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera duhet bërë nga një instalues i autorizuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim. Duke garantuar që ky produkt do të hidhet si duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Për më shumë informacion, kontaktoni instaluesin tuaj ose autoritetin lokal.

- Bateritë janë të shënuara me këtë simbol:

Kjo do të thotë se bateritë NUK mund të përzihen me mbeturinat e paklasifikuara shtëpiake. Nëse një simbol kimik është i shtypur poshtë simbolit, ky simbol kimik do të thotë se bateria mban një metal të rëndë mbi një koncentrim të caktuar.
Simbolet e mundshme kimike janë: Pb: plumb (>0,004%).
Bateritë për hedhje duhen trajtuar në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim. Duke garantuar që bateritë për hedhje do të hidhen si duhet, ju do të ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin njerëzor.

2 Rreth këtij dokumenti

Faleminderit që bletë produktin. Ju lutemi:

- Lexoni me kujdes dokumentacionin para përdorimit të ndërfaqes së përdoruesit për të garantuar performancën më të mirë të mundshme.
- Ruajeni dokumentacionin për referencë në të ardhmen.

Audienca e synuar

Përdoruesit fundorë

INFORMACION

Qëllimi i kësaj pajisjeje është përdorimi nga përdoruesit ekspertë ose të trajnuar në dyqane, në industrinë e lehtë dhe ferma, ose për përdorim tregtar ose shtëpiak nga jo profesionistë.

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë:**
  - Udhëzimet e sigurisë që duhet të lexoni para përdorimit të sistemit
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Manuali i përdorimit:**
  - Udhëzues i shpejt për përdorimin bazë
  - Formati: Letër (te kutia e njësisë së brendshme)
- **Udhëzuesi referencë i instaluesit:**
  - Udhëzime të detajuara hap pas hapi dhe informacion për përdorimin bazë dhe atë të përparuar
  - Formati: Skedarë digjitalë në http://www.daikineurope.com/support-and-manuals/product-information/

Rishikimet më të fundit të dokumentacionit të siguruar mund të disponohen në faqen rajonale Daikin ose përmes instaluesit tuaj.

Dokumentacioni origjinal është i shkruar në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime.

2.1 Një vështrim i shpejtë për udhëzuesi referencë të instaluesit

Kapitulli	Përshkrimi
Masat e përgjithshme paraprake mbi sigurinë	Udhëzimet që DUHET të lexoni mbi sigurinë para përdorimit
Rreth dokumentacionit	Cili dokumentacion ekziston për përdoruesin
Rreth sistemit	▪ Përbërësit ▪ Ndërfaqja e përdoruesit
Para përdorimit	Çfarë duhet bërë para fillimit të përdorimit
Operimi	Operimi i sistemit
Kursimi i energjisë dhe përdorimi optimal	Si të kurseni energji
Mirëmbajtja dhe shërbimi	Mirëmbajtja dhe kryerja e servisit të njësisë
Zgjidhja e problemeve (troubleshooting)	Çfarë duhet bërë në rast problemesh
Hedhja	Si ta hidhni sistemin
Fjalor	Përkufizimet e termave

3 Rreth sistemit

INFORMACION

Niveli i presionit të zërit është më pak se 70 dBA.

ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM

Ftohësit R32 (nëse aplikohet) në këtë njësi është pak i djegshëm. Referojuni specifikimeve të njësisë së jashtme për llojin e ftohësit që do të përdoret.

ALARM

- Mos modifikoni, çmontoni, hiqni, riinstaloni apo riparoni njësinë vetë, sepse çmontimi ose instalimi i pasaktë mund të shkaktojë tronditje elektrike ose zjarr. Kontaktoni distributorin tuaj.
- Në rast rrjedhjeje të rastësishme të ftohësit, sigurohuni që nuk ka flakë të hapura. Vetë ftohësi është krejtësisht i sigurt dhe jo toksik. R410A është një ftohës jo i djegshëm dhe R32 është një ftohës pak i djegshëm, por krijojnë një gaz toksik kur rrjedhin aksidentalisht në dhomë ku ajri i djegshëm nga ngrohësit ventilatorë, sobat me gaz etj. është i pranishëm. Gjithmonë kontaktoni personelin e kualifikuar të shërbimit të konfirmojë që pika e rrjedhjes është riparuar ose ndrequr para rifillimit të operimit.

NJOFTIM

Instalimi i papërshtatshëm ose ngjitja e pajisjeve apo aksesorëve mund të rezultojë në goditje elektrike, qark të shkurtër, rrjedhje, zjarr ose dëme të tjera për pajisjen. Përdor vetëm aksesorë, pajisje opsionale dhe pjesë rezervë prodhuar ose miratuar nga Daikin.

3.1 Përbërësit

INFORMACION

Ilustrimi vijues është thjesht shembull dhe mund të MOS përputhet me planin e sistemit.



a Njësia e brendshme
b Njësia e jashtme
c Ndërfaqja e përdoruesit
d Hyrja e ajrit
e Dalja e ajrit
f Tubacioni i ftohësit dhe instalimet elektrike
g Tubi i kullimit
h Tokëzoni telin me njësinë e jashtme për të parandaluar tronditjet elektrike.

KUJDES

MOS vini gishtat, shufra apo sende të tjera te pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit. MOS e hiqni mbrojtësen e ventilatorit. Kur ventilatori rrotullohet me shpejtësi të lartë, shkaktohet lëndim fizik.

KUJDES

- KURRË mos prekni pjesë të brendshme të kontrollorit.
- MOS e lëvizni panelin e përparmë. Disa pjesë brenda janë të rrezikshme për t'u prekur dhe mund të ndodhin probleme me pajisjen. Për kontrollimin dhe rregullimin e pjesëve të brendshme, kontaktoni distributorin tuaj.

NJOFTIM

Mos e fshij panelin e kontrolluesit të operacionit me benzinë, hollues, leckë pluhuri kimik, etj. Paneli mund të zbardhet ose veshja mund të hiqet. Nëse është shumë pis, zhyt një leckë në detergjent pa ngjyrë holluar me ujë, shtrydhe mirë dhe pastro panelin. Fshije me një leckë tjetër të thatë.

NJOFTIM

Kurrë mos e shtypni butonin e ndërfaqes së përdoruesit me një send të fortë dhe me majë. Mund të dëmtohet ndërfaqja e përdoruesit.

NJOFTIM

Kurrë mos tërhiqni ose rrotulloni telin elektrik të ndërfaqes së përdoruesit. Mund të shkaktojë daljen nga funksioni të njësisë.

3.2 Ndërfaqja e përdoruesit

KUJDES

- KURRË mos prekni pjesë të brendshme të kontrollorit.
- MOS e lëvizni panelin e përparmë. Disa pjesë brenda janë të rrezikshme për t'u prekur dhe mund të ndodhin probleme me pajisjen. Për kontrollimin dhe rregullimin e pjesëve të brendshme, kontaktoni distributorin tuaj.

Ky manual operimi jep një pamje të përgjithshme jo të plotë të funksioneve kryesore të sistemit.

Referojuni manualit të operimit të ndërfaqes së përdoruesit për informacion rreth monitorit dhe butonave të ndërfaqes së përdoruesit.

4 Para operimit

ALARM

Kjo njësi përmban pjesë elektrike dhe të nxehta.

ALARM

Para se të operosh njësinë, siguro që instalimi është kryer siç duhet nga një instalues.

KUJDES

Ekspozimi i trupit ndaj rrymës së ajrit për një kohë të gjatë nuk i bën mirë shëndetit.

KUJDES

Për të shmangur mungesën e oksigjenit, ajrosni dhomën mjaftueshëm nëse pajisjet me djegës përdoren bashkë me sistemin.

KUJDES

MOS e përdorni sistemin kur përdorni një insekticid të llojit të tymosjes së dhomës. Lëndët kimike mund të mblidhen te njësia dhe të rrezikojnë shëndetin e atyre që janë hiper të ndjeshëm ndaj lëndëve kimike.

NJOFTIM

Sigurohuni ta ndizni korrentin për 6 orë para përdorimit në mënyrë që ngrohëses së kollodokut t'i shkojë energji dhe për të mbrojtur kompresorin.

5 Operimi

5.1 Gama e operimit

Për kombinim me njësinë e jashtme R410A, referojuni kësaj tabele:

Njësitë e jashtme		Ftohja	Ngrohja
RR71~125		–15~46°C DB	—
		18~37°C DB 12~28°C WB	—
RQ71~125		–5~46°C DB	–9~21°C DB –10~15°C WB
		18~37°C DB 12~28°C WB	10~27°C DB

Njësitë e jashtme		Ftohja	Ngrohja
RXS25~60		–10~46°C DB	–15~24°C DB –16~18°C WB
		18~32°C DB	10~30°C DB
2MXS50		10~46°C DB	–15~24°C DB –16~18°C WB
		18~32°C DB	10~30°C DB
3MXS40~68 4MXS68~80 5MXS90		–10~46°C DB	–15~24°C DB –16~18°C WB
		18~32°C DB	10~30°C DB
RZQG71~140		–15~50°C DB	–19~21°C DB –20~15,5°C WB
		18~37°C DB 12~28°C WB	10~27°C DB
RZQSG71~140		–15~46°C DB	–14~21°C DB –15~15,5°C WB
		20~37°C DB 14~28°C WB	10~27°C DB
RZQ200~250		–5~46°C DB	–14~21°C DB –15~15°C WB
		20~37°C DB 14~28°C WB	10~27°C DB

Për kombinim me njësinë e jashtme R32, referojuni kësaj tabele:

Njësitë e jashtme		Ftohja	Ngrohja
2MXM50 3MXM40~68		–10~46°C DB	–15~24°C DB –16~18°C WB
4MXM68~80 5MXM90		18~32°C DB	10~30°C DB
RXM25~60		–10~46°C DB	–15~24°C DB –16~18°C WB
		18~32°C DB	10~30°C DB
RZAG35~60		–20~52°C DB	–20~24°C DB –21~18°C WB
		18~32°C DB	10~30°C DB
RZAG71~140		–20~52°C DB	–19,5~21°C DB –20~15,5°C WB
		18~37°C DB 12~28°C WB	10~27°C DB
RZASG71~140		–15~46°C DB	–14~21°C DB –15~15,5°C WB
		20~37°C DB 14~28°C WB	10~27°C DB
Lagështia e brendshme		≤80%(a)	

Simboli	Shpjegimi
	Temperatura jashtë
	Temperatura brenda

(a) Të shmanget kondensimi dhe dalje e ujit jashtë njësisë. Nëse temperatura ose lagështia janë përtej këtyre kushteve, mund të vihen në përdorim pajisjet e sigurisë dhe kondicioneri mund të mos punojë.

6 Kursimi i energjisë dhe operimi optimal

KUJDES

KURRË mos ekspozoni fëmijë të vegjël, bimë apo kafshë direkt me qarkullimin e ajrit.

ALARM

MOS vendosni sende poshtë njësisë së brendshme dhe/ose të jashtme që mund të njomet. Përndryshe kondensimi te njësia kryesore ose tubat e ftohësit, pisllëku i ajrit të filtrit ose bllokimi i drenazhit mund të shkaktojë pikim dhe sendet poshtë njësisë mund të bëhen pis ose dëmtohen.

NJOFTIM

MOS e përdorni sistemin për qëllime të tjera. Për të shmangur çdo përkeqësim të cilësisë, MOS e përdorni njësinë për mjetet e precizonit të ftohjes, ushqimin, bimët, kafshët ose veprat e artit.

KUJDES

MOS e përdorni sistemin kur përdorni një insekticid të llojit të tymosjes së dhomës. Lëndët kimike mund të mblidhen te njësia dhe të rrezikojnë shëndetin e atyre që janë hiper të ndjeshëm ndaj lëndëve kimike.

ALARM

MOS vendosni shishe me spërkatës të djegshëm afër kondicionerit dhe MOS përdorni spërkatës. Kjo gjë mund të shkaktojë zjarr.

Vështroni masat paraprake për të garantuar që sistemi operon si duhet.

- Parandaloni rrezet e drejtpërdrejta të diellit që të hyjnë në dhomë gjatë operimit të ftohjes duke përdorur perde ose grila.
- Ajrosni shpesh. Përdorimi i zgjatur kërkon vëmendje të veçantë për ajrim.
- Mbajini dyert dhe dritaret të mbyllura. Nëse dyert dhe dritaret mbeten të hapura, ajri do të dalë nga dhoma duke shkaktuar një ulje të efektit të ftohjes ose ngrohjes.
- Bëni kujdes MOS të ftohni ose ngrohni shumë. Për të kursyer energji, ruani cilësimin e temperaturës në një nivel mesatar.
- KURRË mos vendosni sende afër pjesës së hyrjes ose daljes së ajrit te njësia. Kjo mund të shkaktojë një efekt të reduktuar të ngrohjes/ftohjes ose ndaljen e operimit.
- Fikni çelësin e energjisë kryesore te njësia kur ajo NUK përdoret për periudha të gjata kohore. Nëse çelësi i energjisë kryesore është i ndezur, njësia konsumon elektricitet. Para rifillimit të njësisë, ndizni çelësin e energjisë kryesore 6 orë para operimit për të siguruar një funksionim të mbarë.
- Kondensimi mund të formohet nëse lagështia është mbi 80% ose nëse shkarkuesi bllokohet.
- Përshtatni temperaturën e dhomës si duhet për një mjedis të rehatshëm. Shmangni ngrohjen ose ftohjen e tepërt. Vini re që mund të duhet pak kohë që temperatura e dhomës të arrijë temperaturën e caktuar. Merrni parasysh përdorimin e opsioneve të cilësimit të kohëmatësit.

- Përshtatni drejtimin e qarkullimit të ajrit për të shmangur grumbullimin e ajrit të ftohtë në dysheme ose ajrit të ngrohtë mes murit. (Lart gjatë ftohjes ose operimit të tharjes në tavan dhe poshtë gjatë operimit të ngrohjes.)
- Shmangni qarkullimin e drejtpërdrejtë të ajrit te personat në dhomë.

7 Mirëmbajtja dhe shërbimi

7.1 Pamje përgjithshme: Mirëmbajtja dhe shërbimi

Instaluesi duhet të kryejë një mirëmbajtje vjetore.

Rreth ftohësit

Ky produkt përmban gazra serë me fluor. MOS i lësho gazrat në atmosferë.

Lloji i ftohësit: R32

Vlera e mundshme e ngrohjes globale (GWP): 675

Lloji i ftohësit: R410A

Vlera e potencialit të ngrohjes globale (GWP): 2087,5

NJOFTIM

Në Evropë, **emetimet e gazrave serë** të ngarkesës së plotë të ftohësit në sistem (shprehur si tone të barasvlershme me CO_2) përdoret për të përcaktuar intervalet e mirëmbajtjes. Ndiqni legjislacionin në fuqi.

Formula për të llogaritur emetimet e gazrave serë: Vlera GWP e ftohësit × Ngarkesa totale e ftohësit [në kg] / 1000

Ju lutemi kontaktoni instaluesin tuaj për më shumë informacion.

ALARM

R410A është një ftohës jo i djegshëm, dhe R32 është një ftohës jo shumë i djegshëm; zakonisht nuk rrjedhin. Nëse ftohësi rrjedh në dhomë dhe bie në kontakt me zjarrin nga një djegës, ngrohëse apo furnelë, kjo mund të shkaktojë zjarr (në rast të R32) ose formimin e një gazi të dëmshëm.

Fikni çdo pajisje ngrohëse të djegshme, ajrosni dhomën dhe kontaktoni distributorin ku keni blerë njësinë.

MOS e përdorni njësinë derisa një person shërbimit të konfirmojë që pjesa nga e cila ka rrjedhë ftohësi është riparuar.

ALARM

- MOS i shpo apo digj pjesët e ciklit të ftohësit.
- MOS përdor materiale pastrimi ose mjete për të përshpejtuar procesin e heqjes së akullit ndryshe nga ato që rekomandohen nga prodhuesi.
- Ki parasysh që ftohësi brenda sistemit është pa aromë.

NJOFTIM

Mirëmbajtja DUHET të kryhet nga një instalues i autorizuar ose agjent shërbimi.

Ne rekomandojmë kryerjen e mirëmbajtjes të paktën një herë në vit. Megjithatë, legjislacioni në fuqi mund të kërkojë intervale më të shkurtra të mirëmbajtjes.

KUJDES

Para se të hysh në pajisjet terminale, sigurohu të ndërpresësh të gjitha furnizimet me energji elektrike.

RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Për të pastruar kondicionerin ose filtrin e ajrit, sigurohuni të ndalni operacionin dhe t'i fikni të gjitha furnizimet me energji. Përndryshe, kjo mund të shkaktojë shok elektrik dhe lëndim fizik.

ALARM

Për të parandaluar goditjet elektrike ose zjarrin:

- MOS e shpëlaj njësinë.
- MOS e përdor njësinë me duar të lagura.
- MOS vendos asnjë send që përmban ujë mbi njësi.

KUJDES

Pas një përdorimi të gjatë, kontrollo mbështetësen e njësisë dhe montimin për dëmtime. Nëse dëmtohet, njësia mund të rrëzohet dhe çojë në dëmtim.

KUJDES

MOS i prekni krahët e shkëmbyesit të energjisë. Këto krahë janë të mprehtë dhe mund të çojnë në prerje.

NJOFTIM

Kur pastroni shkëmbyesin e nxehtësisë, sigurohuni të hiqni kutinë e çelësit dhe motorin e ventilatorit. Uji ose detergjenti mund ta përkeqësojnë izolimin e elementeve elektronike dhe mund të rezultojnë në djegien e këtyre elementeve.

ALARM

Bëni kujdes me shkallët kur punoni në vende të larta.

7.2 Pastrimi i tiganit të kullimit

Pastroni tiganin e kullimit që MOS të bllokohet apo bëhet me pluhur.

7.3 Pastrimi i filtrit të ajrit, grilës së thithjes, daljes së ajrit dhe paneleve të jashtëm

7.3.1 Pastrimi i daljes së ajrit dhe paneleve të jashtme

ALARM

MOS e lër njësinë e brendshme të laget. **Pasoja e mundshme:** Goditje elektrike ose zjarr.

NJOFTIM

- MOS përdor gazolinë, benzinë, pluhur hollues pastrimi ose insekticide të lëngshme. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosja dhe deformimi.
- MOS përdor ujë ose ajër 50°C ose më lart. **Pasoja e mundshme:** Çngjyrosja dhe deformimi.
- Kur lan tehun me ujë MOS e fërko fort. **Pasoja e mundshme:** Hiqet pjesa mbyllëse e sipërfaqes.

Pastro me një leckë të butë. Nëse heqja e njollave është e vështirë, përdor ujë ose detergjent pa ngjyrë.

7.3.2 Pastrimi i filtrit të ajrit

Kur pastrohet filtri i ajrit:

- Rregulli i gishtit të madh: Pastroni çdo 6 muaj. Nëse ajri në dhomë është i ndotur jashtë mase, rrisni frekuencën e pastrimit.

- Në varësi të rregullimeve, ndërfaqja e përdoruesit mund të shfaqë njoftimin **KOHA PËR TË PASTRUAR FILTRIN E AJRIT.** Pastroni filtrin e ajrit kur shfaqet njoftimi.
- Nëse pastrimi i pisllëkut është i pamundur, ndërroni filtrin e ajrit (=pajisje opsionale).

Si të pastrosh filtrin e ajrit:

1 **Hiqni filtrin e ajrit.** Shtyni çengelat dhe tërhiqni filtrin siç tregohet poshtë në ilustrim. (2 çengela për llojin 25 dhe 35 ose 3 çengela për llojin 50 dhe 60)



2 **Pastroni filtrin e ajrit.** Përdorni një pompë vakumi ose lani me ujë. Nëse filtri i ajrit është shumë i pistë, përdorni një furçe të butë dhe detergjent neutral.



3 **Thani filtrin e ajrit në hije.**

4 **Ringjitni filtrin e ajrit.** Varni filtrin mbrapa kapakut të xhepit dhe ngjiteni te njësia kryesore duke shtyrë për poshtë çengelat.



5 NDIZNI energjinë.

6 Shtypni butonin **RIVENDOSJE E SHENJËS SË FILTRIT**.

Rezultati: Njoftimi **KOHA PËR TË PASTRUAR FILTRIN E AJRIT** zhduket nga ndërfaqja e zotëruesit.

7.4 Mirëmbajtja para një periudhe të gjatë ndalese

P.sh. në fund të stinës.

- Lërini njësitë e brendshme të punojnë vetëm me ventilator për rreth gjysmë dite për të tharë pjesën e brendshme të njësive.
- Fikni energjinë. Monitori i ndërfaqes së përdoruesit zhduket. Kur ndizet energjia kryesore, kondicioneri do të përdorë energji, edhe nëse nuk operon.
- Pastroni filtrat e ajrit dhe veshjet e jashtme të njësive të brendshme. Kontaktoni instaluesin ose personin e mirëmbajtjes për të pastruar filtrat e ajrit dhe veshjet e jashtme të njësisë së brendshme. Këshilla dhe procedura për mirëmbajtjen jepen në manualet e instalimit/operimit të njësive të dedikuara të brendshme. Sigurohuni të instaloni filtrat e pastruar të ajrit në të njëjtin pozicion.
- Hiqni bateritë nga ndërfaqja e përdoruesit.

7.5 Mirëmbajtja pas një periudhe të gjatë ndalese

P.sh. në fillim të stinës.

- Kontrollo dhe hiq çdo gjë që mund të bllokojë ventilatorët e hyrjes dhe daljes të njësive të brendshme dhe të jashtme.
- Kontrolloni nëse tokëzimi është i lidhur si duhet.
- Kontrolloni nëse diku ka tel të dëmtuar. Kontaktoni distributorin tuaj në rast problemesh.
- Pastroni filtrat e ajrit dhe veshjet e jashtme të njësive të brendshme. Kontaktoni instaluesin ose personin e mirëmbajtjes për të pastruar filtrat e ajrit dhe veshjet e jashtme të njësisë së brendshme. Këshilla dhe procedura për mirëmbajtjen jepen në manualet e instalimit/operimit të njësive të dedikuara të brendshme. Sigurohuni të instaloni filtrat e pastruar të ajrit në të njëjtin pozicion.
- Ndize energjinë të paktën 6 orë para operimit të njësisë që të sigurosh operim të rregullt. Sapo të ndizet energjia, shfaqet ekrani i ndërfaqes së përdoruesit.

8 Zgjidhja

Nëse ndodh njëra nga këto keqfunksionime, merrni masat e treguara poshtë dhe kontaktoni distributorin tuaj.

ALARM

Ndalo operimin dhe fik energjinë, nëse ndodh diçka e pazakontë (erë djegieje, etj.).

Lënia e njësisë në punë në këto rrethana mund të shkaktojë prishje, tronditje elektrike ose zjarr. Kontakto shitësin tënd.

Sistemi DUHET të riparohet nga një person i kualifikuar për shërbim.

Nëse sistemi NUK operon si duhet përveç rasteve të lartpërmendura dhe asnjëra nga keqfunksionimet e përmendura nuk është e dukshme, hetoni sistemin në përputhje me procedurat vijuese.

Keqfunksionimi	Masa
Nëse sistemi nuk operon fare.	▪ Kontrolloni nëse ka avari të energjisë. Prisni derisa të rikthehet energjia. Nëse gjatë përdorimit ndodh një avari e energjisë, sistemi rifillon automatikisht menjëherë pas rikthimit të energjisë. ▪ Kontrolloni nëse është djegur siguresa ose është aktivizuar çelësi. Ndërroni siguresën ose rivendosni çelësin nëse është e nevojshme. ▪ A janë bateritë e vendosura në telekomandë? ▪ A është rregullimi i matësit i saktë?

Keqfunksionimi	Masa
Sistemi operon, por ftohja ose ngrohja nuk mjafton.	▪ Kontrolloni nëse pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit të njësisë së jashtme ose të brendshme nuk bllokohet nga pengesa. Hiqni çdo pengesë dhe sigurohuni që ajri mund të qarkullojë lirshëm. ▪ Kontrolloni nëse filtri i ajrit është i bllokuar. Kontaktoni distributorin tuaj për të pastruar filtrin e ajrit. ▪ Kontrolloni cilësimin e temperaturës. Referojuni manualit të ndërfaqes së përdoruesit. ▪ Kontrolloni nëse këndi i rrjedhjes së ajrit është në rregull. Referojuni manualit të ndërfaqes së përdoruesit. ▪ Kontrolloni nëse shpejtësia e ventilatorit është vendosur tek e ulëta. Referojuni manualit të ndërfaqes së përdoruesit. ▪ Kontrolloni për dyer ose dritare të hapura. Mbyllni dyer dhe dritare për të penguar futjen e erës brenda. ▪ Kontrolloni nëse në dhomë hyjnë rrezet e diellit. Përdorni perde ose grila. ▪ Nëse burimi i energjisë së dhomës është i tepërt (gjatë ftohjes). Efekti i ftohjes ulet nëse rritja e ngrohjes në dhomë është shumë e madhe. ▪ Kontrolloni nëse në dhomë ka shumë njerëz gjatë operimit të ftohjes. Kontrolloni nëse burimi i energjisë së dhomës është i tepërt.
Operimi ndalon papritur. (Llamba e operimit vezullon.)	▪ Kontrolloni nëse filtri i ajrit është i bllokuar. Kontaktoni distributorin tuaj për të pastruar filtrin e ajrit (referojuni "Mirëmbajtja" në manualin e njësisë së brendshme). ▪ Kontrolloni nëse pjesa e hyrjes ose daljes së ajrit të njësisë së jashtme ose të brendshme nuk bllokohet nga pengesa. Hiqni çdo pengesë, OFF dhe ON sërish siguresën. Nëse llamba vazhdon të vezullojë, kontaktoni distributorin tuaj. ▪ Kontrolloni nëse të gjitha njësitë e brendshme janë të lidhura me njësinë e jashtme në multi-sistem operojnë në të njëjtin modalitet.
Ndodh një funksionin anormal gjatë operimit.	▪ Kondicioneri mund të keqfunksionojë për shkak të vetëtimave ose valëve të radios. Kthejeni çelësin në OFF dhe sërish te ON.

Nëse pas kontrollimit të të gjithë artikujve të mësipërm, zgjidhja e problemit është i pamundur, kontaktoni instaluesin tuaj dhe konstatoni simptomat, emri i plotë i modelit të njësisë (me numrin e prodhimit nëse është e mundur) dhe data e instalimit (mundësisht renditur te karta e garancisë).

8.1 Simptomat që NUK janë keqfunksionime të sistemit

Simptomat vijuese NUK janë keqfunksionime të sistemit:

8.1.1 Shenja: Sistemi nuk operon

- Kondicioneri nuk fillon menjëherë pasi shtypet butoni i NDEZJES/FIKJES në ndërfaqen e përdoruesit. Nëse ndizet llamba e operimit, kondicioneri është në gjendje normale. Nuk rifillon menjëherë, sepse një nga pajisjet e sigurisë aktivizohet për të penguar mbingarkimin e kondicionerit. Kondicioneri ndizet sërish automatikisht pas 3 minutave.
- Kondicioneri nuk fillon menjëherë pasi ndizet furnizimi me energji. Prisni 1 minutë derisa të përgatitet mikrokompjuteri për operim.
- Kondicioneri nuk rifillon menjëherë kur butoni i vendosjes së temperaturës kthehet në pozicionin e tij të mëparshëm pas shtypjes. Nuk rifillon menjëherë, sepse një nga pajisjet e sigurisë aktivizohet për të penguar mbingarkimin e kondicionerit. Kondicioneri ndizet sërish automatikisht pas 3 minutave.
- Njësia e jashtme ka ndaluar. Kjo ndodh sepse temperatura e dhomës ka arritur temperaturën e caktuar. Njësia kalon në operimin e ventilatorit. "[ ]" (ikona e kontrollit të jashtëm) shfaqet në ndërfaqen e përdoruesit dhe operimi aktual është ndryshe nga vendosja e ndërfaqes së përdoruesit. Për modelet me shumë ndarje, mikrokompjuteri ekzekuton kontrollin vijues në varësi të modalitetit të operimit të njësive të tjera të brendshme.
- Shpejtësia e ventilatorit është ndryshme nga rregullimi. Shtypja e butonit të kontrollit të shpejtësisë së ventilatorit nuk e ndryshon shpejtësinë e ventilatorit. Kur temperatura e dhomës arrin nivelin e duhur në modalitetin e ngrohjes ose arrihet kapaciteti maksimal i njësisë, njësia e jashtme ndalon operimin dhe njësia e brendshme operon vetëm me ventilator (shpejtësi e ulët ventilatori). Nëse është me shumë ndarje, njësia e brendshme operon në modalitetin e ndalimit të ventilatorit dhe modalitetin vetëm me ventilator (LL= shpejtësi e ulët ventilatori). Kjo ndalon fryrjen e ajrit të ftohtë direkt dikujt që është i pranishëm në dhomë.

8.1.2 Shenja: Nga njësia (njësia e brendshme) dalin pikla të bardha

- Kur lagështia është e lartë gjatë operimit të ftohjes (në vende me vaj dhe pluhur). Nëse pjesa e brendshme e një njësie të brendshme është ndotur keq, shpërndarja e temperaturës brenda dhomës bëhet jo e rregullt. Është e nevojshme pastrimi i pjesës së brendshme të njësisë së brendshme. Pyesni distributorin tuaj për detaje mbi pastrimin e njësisë. Ky operim kërkon një person të kualifikuar shërbimi.
- Kur kondicioneri kalon në operimin me ngrohje pas heqjes së ngricës. Lagështia e krijuar nga heqja e ngricës bëhet avull dhe del.

8.1.3 Shenja: Nga njësia del pluhur

Kur njësia përdoret për të parën herë në një kohë të gjatë. Kjo ndodh sepse në njësi ky hyrë pluhur.

8.1.4 Shenja: Njësitë mund të lëshojnë aroma

Njësia mund të thithë erën e dhomave, mobilieve, cigareve, etj., dhe pastaj i lëshon sërish.

8.1.5 Simptoma: Operimi ndalon papritur (llamba e operimit ndizet)

Kondicioneri mund të ndalojë për mbrojtjen e sistemit për shkak të luhatjes së madhe të voltazhit. Ai vazhdon automatikisht operimin pas 3 minutave.

8.1.6 Simptoma: Ventilatori i jashtëm rrotullohet kur kondicioneri nuk është në përdorim

- **Pasi ka ndaluar operimi.** Ventilatori i jashtëm vazhdon të rrotullohet për 30 sekonda të tjera për mbrojtjen e sistemit.

- **Kur kondicioneri nuk është në përdorim.** Kur temperatura e jashtme është shumë e lartë, ventilatori i jashtëm fillon të rrotullohet për mbrojtjen e sistemit.

8.1.7 Simptoma: Operimi i ngrohjes ndalon papritur dhe dëgjohet një zë rrjedhjeje

Sistemi po heq ngricën nga njësia e jashtme. Duhet të presësh për rreth 3 deri 8 minuta.

9 Hedhja

NJOFTIM

MOS provoni ta çmontoni vetë sistemin: çmontimi i sistemit, menaxhimi i ftohësit, vajit dhe pjesëve të tjera DUHET të përputhet me legjislacionin në fuqi. Njësitë DUHET të trajtohen në një vend për trajtim të specializuar për ripërdorim, riciklim dhe rikuperim.

10 Fjalor

DHW = Ujë i nxehtë shtëpiak
Ujë i nxehtë i përdorur në çdo lloj ndërtese, për qëllime shtëpiake.

LWT = Temperatura e ujit që largohet
Temperatura e ujit te shkarkuesi i ujit të pompës së ngrohjes.

Shitësi
Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar
Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi
Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi
Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit
Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.

Manuali i instalimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit
Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Aksesorë
Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale
Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizuar nga instaluesi
Pajisje të prodhuara JO nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet te dokumentacioni shoqërues.

Copyright 2018 Daikin

DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.
U Nové Hospody 1/1155, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.
Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

4P543324-1 2018.07